

RAPORT VJETOR

2018



DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE

Vizioni i D&E: “Ne besojmë në një shoqëri pa trafikim, shfrytëzim apo diskriminim, ku çdo njeri/ës i respektohen të drejtat dhe i jepen mundësi të barabarta”



Shërbime
komunitare



Shërbime
rezidenciale





Advokim



Kujdes alternativ
për fëmijët



Mbështetje për
politikë -bërësit



DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE



Studime /Kërkime



Ndërgjegjësimi
i komunitetit



Aktivitetet për
gjenerim të
ardhurash



Mentorim



Shërbim ligjor
falas

TABELA E PËRMBAJTJES

I. PËRFITUESIT/ET E PROGRAMIT

-  Profili i rasteve viktime / viktime të mundshme trafikimi
-  Profili i rasteve viktime të abuzimit dhe dhunës në familje

II. FUSHAT E VEPRIMTARISË SË D&E GJATË 2018

-  Programi i riintegritit për viktimat /viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri
-  Shërbime alternative të përkujdesjes së fëmijëve të nënave viktime trafikimi dhe viktime të dhunës në familje
-  Rritja e aksesit të viktimave në sistemin e drejtësisë
-  Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushata anti-trafikimi
-  Mbështetja e viktimave të trafikimit për të dizenuar dhe zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi
-  Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave

III. NGRITJE E KAPACITETIT TË STAFIT TË D&E

-  Trajnime dhe prezantime të ofruara nga D&E
-  Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit

IV. AKTIVITETE PËR NGRITJEN E FONDEVE

V. BOTIME DHE PUBLIKIME TË D&E

VI. VLERËSIME, ÇMIME



Përfituesit/et e programit




Profili i rasteve viktima / viktima të mundshme trafikimi



I. Përfituesit e programit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018 janë asistuar në total në programin riintegruës të organizatës **99 raste dhe 107 fëmijë të tyre**.

 **65 përfituese** të asistuar në program janë **viktima /viktima të mundshme trafikimi** dhe **23 fëmijë të tyre** dhe **34 raste janë viktima të abuzimit seksual dhe dhunës në familje** dhe **84 fëmijë të tyre**.




Kategoritë e përfitueseve të asistuar në program

Kategori	Total i rasteve të asistuar në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018	Rastet e mbartura nga Dhjetor 2017	Rastet e reja në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018
Viktima trafikimi / Viktima të mundshme trafikimi	65	36	29
Viktima të dhunës dhe abuzimit	34	19	15
Fëmijë të rasteve viktima/viktima të mundshme trafikimi shoqëruar me nënat e tyre	23	7	16
Fëmijë të rasteve viktima dhune dhe abuzimi	84	44	40
Totali	206	106	100

PROFILI I RASTEVE VIKTIMA / VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI

 Gjinia


Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja	Total
Femra	25	22	47
Meshkuj	11	7	18
TOTAL	36	29	65



66% e rasteve të reja të hyra në program gjatë këtij viti kanë qenë minorenë



Vendet nga të cilat vijnë viktimat e trafikimit



Lëvizja e familjeve të rasteve viktimat trafikimi:



↔ 3 familje kanë lëvizur nga **Kukësi** dhe janë vendosur në **Tiranë**



↔ 2 familje kanë lëvizur nga **Laçi** dhe Tropoja dhe janë vendosur në **Durrës**



↔ 2 familje kanë lëvizur nga **Berati** dhe Vlora dhe janë vendosur në **Tiranë**

Etnia

15 raste viktimat /viktimat të mundshme trafikimi janë të komunitetit Rom dhe Egypcian



 Shtetësia

Shteti	Nr i rasteve të mbartura	Nr. i rasteve të reja
Shqipëri	32	28
Rumani	1	-
Bjellorusi	1	-
Filipine	1	-
Itali	-	1

 Statusi

Statusi	Beqar/e	I/e martuar	I/e divorcuar	Bashkëjetesë
Nr. i rasteve	24	3	1	1

 Niveli arsimor i rasteve të reja

Niveli arsimor	Pa arsim	Fillor	8-9 vjeçar	8-9 vjeçar /i papërfunduar	E mesme	E mesme /e papërfunduar
Nr i rasteve	3	3	11	9	2	1

Konteksti familjar

Në pjesën më të madhe të rasteve të viktimave të trafikimit, problemet e tyre kanë nisur që në fëmijëri. Vijnë nga familje problematike dhe disfunktionale ku marrëdhëniet midis prindërve me njëri – tjetrin si dhe marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve janë të këqija, konfliktuale dhe shumë problematike.

Pjesa më e madhe e tyre janë prindër të dhunshëm, neglizhues, prindër që braktisin dhe dëbojnë nga shtëpia fëmijët e tyre dhe në shumicën e rasteve kanë nivel të ulët arsimor.

Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve (45% e tyre), prindërit janë të divorcuar. Të jetuarit me njerkun/ njerken dhe marrëdhënia konfliktuale me ta ka sjellë largimin e tyre nga shtëpia. 1 rast është abuzuar dhe seksualisht

” Babai gjithmonë ka qënë i dhunshëm. Më gjuante madje me sende të forta aq sa ndonjëherë humbisja ndjenjat. Ato shenja i kam sot e kësaj dite e do ti kem për gjithë jetën time...

Eva, 17 vjeç

"U abuzova seksualisht nga njerku, dhe kur i tregova mamit se çfarë më kishte ndodhur, nuk më besoi dhe madje më tha se isha e çmendur..."

Besa, 19 vjeç

"U rrita nga gjyshërit. Mamaja nuk është kujdesur dhe nuk ka dashur të kujdeset ndonjëherë për mua! Babi... nuk ka dashur të më njohë që kur linda"

Monika, 23 vjeç


Në disa raste ku prindërit i kanë braktisur, një pjesë e tyre kanë jetuar me gjyshërit të cilët janë të pafuqishëm për t'u kujdesur për to.

65% e rasteve vijnë nga familje me nivel të ulët ekonomik, ku njëri nga prindërit apo të dy janë të papunë. Në dy raste anëtarët e familjes, babai apo vëllezërit janë përfshirë në kryerjen e veprave kriminale dhe janë dënuar.

Më poshtë janë renditur faktorët të lidhur me kontekstin e familjes të cilët kanë ndikuar dhe kanë çuar më pas në situatën e shfrytëzimit e trafikimit:

- ❖ Të braktisur nga prindërit
- ❖ Familje me prindër të divorcuar
- ❖ Vdekja e njërit prej prindërve
- ❖ Jetesa me njerkun /njerken
- ❖ Jetesa me gjyshërit
- ❖ Rritur në institucion fëmijësh
- ❖ Njëri nga prindërit në burg / familje me probleme penale dhe policore
- ❖ Dhunë fizike dhe psikologjike nga njëri apo të dy prindërit
- ❖ Prindër të alkolizuar
- ❖ Abuzim seksual
- ❖ Një nga prindërit apo të dy me probleme të shëndetit mendor
- ❖ Nivel i ulët ekonomik /varfëri
- ❖ Nivel i ulët arsimor i prindërve
- ❖ Martesë e detyruar në moshë të mitur
- ❖ Prindër të cilët nuk janë të pranishëm pothuajse fare në problemet e tyre.

↔ Mënyra e rekrutimit



21% e rasteve kanë patur si mënyrë rekrutimi ndikimin shoqëror për përfshirjen në situatë të rrezikshme për shfrytëzim. Të gjitha këto raste kanë qenë të mitur nën moshën 16 vjeç.

31% e rasteve janë **mashtruar dhe detyruar** për t'u shfrytëzuar nga i dashuri dhe në pjesën më të madhe nga bashkëjetuesi, si dhe nga anëtarë të familjes.

Rastet të cilët janë **detyruar dhe shfrytëzuar për lypje** nga anëtarët e familjes dhe persona të tjerë janë **raste të meshkujve** të cilët në momentin e hyrjes në programin e organizatës kanë qenë 18 vjeç, që do të thotë që shfrytëzimi ka ndodhur kur ata kanë qenë **minorenë**.

Rastet që kanë patur si mënyrë rekrutimi premtim për strehim, ushqim, plotësimin e nevojave bazike. Këto raste kanë qenë në **situatë rruge** dhe janë **shfrytëzuar** kryesisht në kryerjen e **aktiviteteve kriminale** si **shpërndarje droge** dhe **vjedhje**.



Vendi ku kanë qenë trafikuar


Vendi ku janë trafikuar	Nr i rasteve të mbartura	Nr i rasteve të reja	Total
Shqipëri	27	21	48
Kosovë	1	1	2
Itali	-	2	2
Gjermani	-	1	1
Angli	1	1	2
Zvicër	1	-	1
Greqi, Shqipëri	3	-	3
Kosovë, Shqipëri	1	1	2

Gjermani, Shqipëri	-	1	1
Itali, Shqipëri	1	1	2

Format e shfrytëzimit

Forma e shfrytëzimit	Nr. i rasteve të mbartura	Nr. i rasteve të reja	Total
Shfrytëzim seksual	23	17	40
Martësë e detyruar	1	1	2
Lypje	-	4	4
Aktivitet kriminal	4	3	7
Shfrytëzim seksual & Punë e detyruar	4	1	5
Shfrytëzim seksual & Lypje	2	1	3
Shfrytëzim seksual & Aktivitet kriminal	1	1	2
Lypje dhe punë e detyruar	-	1	1

 **Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar – Dhjetor 2018:**



II. PROFILI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE ABUZIMIT

 **34 raste të asistuar në program gjatë 2018 janë viktima të abuzimit seksual dhe dhunës në familje dhe 84 fëmijë të tyre.**

 **15 raste dhe 40 fëmijë të tyre janë raste të reja të hyra në program gjatë 2018.**



Gjinia

Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja	TOTAL
Femra	19	14	33
Meshkuj	-	1	1
Total	19	15	34



Mosha

Mosha	13 - 15	16-18	19-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Nr. i rasteve të mbartura	0	0	3	4	4	8	19
Nr. i rasteve të reja	2	1	3	2	4	3	15
Total	2	1	6	6	8	11	34



Vendet nga të cilat vijnë viktimat e dhunës në familje

Qarku	Bashkia	Qytet	Fshat	Total
Elbasan	Bashkia Cërrik		1	1
Fier	Bashkia Fier	1		6
	Bashkia Lushnjë	4	1	
Kukës	Bashkia Kukës		1	1

Lezhë	Bashkia Mirditë		1	1
Shkodër	Bashkia Pukë		1	2
	Bashkia Shkodër		1	
Tiranë	Bashkia Tiranë	2	1	3
Suedi		1		1
TOTAL		8	7	15

 Niveli arsimor i rasteve të reja



 Statusi

Statusi	Beqar/e	I/e martuar	I/e divorcuar	Bashkëjetesë
Nr. i rasteve	2	2	7	4

 Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar – Dhjetor 2018

Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
Qendra Kombëtare e trajtimit të viktimave të dhunës në familje	3
Ministria e Brendshme	1
Sherbimi ligjor falas D&E	1
Tjeter Vizion	1
Dimak / Giz	1
Vetereferuar	1
Ambasada Suedeze	1
Forumi i Gruas EL	1
Inspektoriati i Punes	1
CPU (Nr.2, Shkoder)	2
Njësia Lëvizese	2
TOTAL	15


Projekte të zbatuara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018

- ✎ Programi i riintegrit për viktimat /viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri
- ✎ Shërbime alternative të përkujdesjes së fëmijëve të nënave viktimatrafikimi dhe viktimat të dhunës në familje
- ✎ Rritja e aksesit të viktimave në sistemin e drejtësisë
- ✎ Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushata anti-trafikimi
- ✎ Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave



Programi i riintegrit për viktimat /viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri

Donatorë: Pro Victims; UNOHCHR; Ambasada Amerikane; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes Qarkut Tiranë dhe Bashkisë Tiranë



Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktime të abuzimit, trafikimit dhe dhunës në familje

D&E ka ofruar asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit në tre faza:

Faza #1: Ndërhyrja në situatë krize dhe Akomodimi



Faza #2: Faza tranzit e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur



Faza #3: Riintegrimi dhe përfshirja sociale



Shërbimet shëndetësore

Mjeku i D&E ka bërë vlerësimin mjekësor të rasteve të reja të hyra në program dhe gjithashtu ka adresuar dhe trajtuar nevojat mjekësore të të gjitha përfitueseve të programit të riintegrit, për përfitueset që janë të akomoduara në qendrën e riintegrit por edhe për ato të cilat janë në fazën e dytë të programit. Për çdo rast të ri të hyrë në program janë bërë analizat rutinë (gjak komplet, urinë dhe ekzaminime për SST).




3 përfituese shtatzënë janë mbështetur me asistencën e duhur mjekësore dhe janë ndjekur nga mjeku obstetër-gjinekolog.

Janë hospitalizuar në QSUT dy raste përkatësisht në Shërbimin e Psikiatrisë me diagnozë çrregullim humori të paspecifikuar me tentative suicidale dhe në Shërbimin e Pediatriës me diagnozë Bronkopneumoni bilaterale.



Diagnoza mjekësore

Sëmundja	Nr. i rasteve	Nr. i fëmijëve
Probleme gastro-intesitnale	9	6
Probleme dermatologjike	13	8
ORL	4	7
Probleme alergjike	8	4
Probleme gjinekologjike	14	
Anemi	6	3
Probleme dentare	16	2
Okulist	5	2
Djegje plastike	5	
Probleme reumatizmale	1	
Ortopedi-Traumatologji	15	
Colia abdominal dhe renale	3	
Probleme infektive	17	25



Probleme të shëndetit mendor

11

përfitues/ e me probleme të shëndetit mendor janë ndjekur rregullisht nga psikiatri duke marrë trajtimin e duhur në vazhdimësi

Çrregullime mendore/Sëmundje	Përfituese
PTSD	3
Borderline	1
Çrregullime të Depresionit	3
Çrregullim ankthi	1
Skizofreni / çrregullim skizo-afektiv	3

Është realizuar pajisja me kartat e shëndetit të përfitueseve të asistuar në programin e D&E, duke patur kështu mundësinë të përfitojnë një sërë shërbimesh shëndetësore falas.

- D&E ka bashkëpunuar me **Albanian University - Dega Stomatologji**, nëpërmjet të cilit janë siguruar shërbime dentare falas për përfitueset e programit. D&E ka bashkëpunuar me disa institucione shtetërore sic janë: **Poliklinika Nr.9, ISHP, Istituti i Higjenes, Poliklinika Dentare “Ufo”, Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” dhe “Mbretëresha Geraldine” Urgjenca Polivalente e QSUT dhe Urgjenca Pediatrike.**

Këshillimi psikologjik dhe psiko-social, terapia e artit, terapia okupacionale, teknikat e relaksimit janë aktivitetet e organizuara në kuadër të asistencës psiko-sociale. Të gjitha këto aktivitete synojnë mirëqenien psikologjike të përfitueseve.

	Këshillim individual psikologjik ofruar nga Psikologu	Këshillim individual psiko - social ofruar nga menaxherët e rasteve	Terapi Arti në grup	Punë krijuese dhe Terapi Okupacionale	Teknika relaksuese
Nr. i sesioneve	814	3472	42	40	2



Këshillim psikologjik

Një vlerësim psiko-social është bërë për rastet që kanë hyrë në program. **814 seanca këshillimi individuale janë ofruar nga psikologu.** Gjatë kësaj periudhe çështjet e trajtuara në seancat e këshillimit kanë qenë: *Simptomat e ankthit; Çrregullime të personalitetit; Problemet e gjumit; Problemet e Sjelljes; Simptomat e depresionit.*



Terapi arti

Terapia e artit ka ndikuar pozitivisht tek përfituesit e D&E duke qenë një aktivitet i çlirimit të stresit, relaksim, krijimtari, rritje e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit, duke u konsideruara kështu një aktivitet i rëndësishëm për mbështetjen psikologjike.

42 sesione Art -Terapie janë organizuar gjatë kësaj periudhe dhe teknikat e përdorura kanë qenë:

Dhurata ime personale; Mirënjohja dhe dëshirat; Historia Ime;

Ndjenjat e mia; Përceptimi im i botës; Tema e lirë; Poster afirmimi;

Lighthouse; Aftësia ripërtëritëse; Krijë një person; Rishkruaj historinë;

Pikturo një portret të grupit; Fëmija i Brendshëm; Çantat / kutitë brenda-jashtë;

Ndjesia e kolazhit të kodit; Mirënjohja dhe Urimet; Mandala;

Pikturimi i ëndrrës tuaj; Zentangle; Çfarë është në duart e mia?;

Pikturë me gisht; Ngjyrosni ndjenjat tuaja;

Punë kreative dhe terapi okupacionale

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar **40 seanca të Terapisë Okupacionale** me pjesëmarrjen e 16 përfituesve. Përfitueset kryesisht vlerësojnë se si ky aktivitet i ndihmon ato të punojnë në mënyrë konstruktive në grup; i bën ato të ndërgjegjshme për disa aftësi të mira që nuk e dinin se i kishin; i bën të vetëdijshëm për kreativitetin e tyre; rrit besimin në vetvete duke i bërë të ndihen të denja dhe të sigurt për atë që realizojnë; mësojnë të kërkojnë ndihmë kur kanë nevojë për të; mësojnë të jenë të fokusuar dhe të durueshme.

Disa nga aktivitetet e organizuara ishin:

Bizhuteri – gjerdan, rrathë, vathë; punë dore në letër; Punë dore në çimento; dhe në suva; Krijime me materiale të ricikluara (shishe, peshqirë, gazeta etj.) ; Korniza druri; Piktura në kanavac me materiale të ndryshme; Krijim personal me kopsa; T-shirt i personalizuar; Krijime me materiale plastike; Dekorim i murit; Kartolina; Vazo lulesh me materiale të ricikluara; Punime me materiale të ricikluara të kancelarisë; Dekorim i gurit; Ornament druri.



Këshillimi psiko-social

3472 seanca individuale të këshillimit psiko-social janë ofruar nga menaxherët e rasteve. Çështjet e sjella në këshillim janë kryesisht të lidhura me punësimin, marrëdhëniet, ndërmjetësimin me familjen, fuqizimin, menaxhimin e kohës dhe të ardhurave, vendimmarrjen dhe zgjedhjet, prindërimin, arsimin, vetë-kujdesin dhe jetesën e pavarur.





Teknika relaksuese

Ky aktivitet është organiuar dhe lehtësuar nga nje vullnetare e organizatës. Gjatë këtyre sesioneve, përfituesit janë njohur me përfitimet e teknikave të relaksimit, në lehtësimin dhe çlirimin e stresit dhe ankthit. Janë organizuar **2 seanca relaksuese** duke përdorur teknika imagjinare, relaksim të muskujve, teknikat e frymëmarrjes.



Edukimi dhe shkollimi

Një vlerësim për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfitueseje në program realizohet nga mësuesja e D&E dhe në bazë të këtij vlerësimi zhvillohet një plan edukativo – mësimor si pjesë e planit të riintegrit të çdo përfitueseje.

Gjatë kësaj periudhe **28 përfituese VeT dhe 6 fëmijë të tyre janë** mbështetur dhe kanë ndjekur shkollën në nivele të ndryshme. **31 fëmijë të viktimave të dhunës** janë mbështetur gjithashtu.

Shkolla	Nr. i përfitueseve VT/VMT	Nr. i fëmijëve të VT/VMT	Nr. i përfitueseve VDH	Nr. i fëmijëve të rasteve VDH
Shkollë 9 – vjeçare	13	6	-	28
Shkollë e Mesme	13	0	-	3
Universitet	2	0	-	-
Total	28	6	-	31

Mësuesi i D&E i ka shoqëruar rastet në qytetet ku kanë jetuar për të tërhequr dokumentet shkollore dhe për t'i regjistruar ato në shkollat e tjera në Tiranë.

D&E ka bashkëpunuar me drejtorët e shkollës 9-vjeçare dhe shkollës së mesme ku përfituesit e programit kanë ndjekur shkollën. Një rast është regjistruar dhe ka ndjekur një shkollë private për shkak të problemeve të saj të sigurisë. Të gjitha rastet janë mbështetur me libra shkollorë dhe materiale.



Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

Trajnime për punësim / kurse profesionale

24 përfitues/e kanë ndjekur kurse profesionale. Disa përfitues kanë ndjekur më shumë se një kurs, bazuar në aftësitë dhe dëshirat individuale.

Kurse / trajnime profesionale

No.	Kurse	Ofruar	Nr. I rasteve
1.	Kurs kompjuteri	Qendra e Edukimit D&E	16
2.	Anglisht	Qendër e gjuhëve të huaja	1
3.	Italisht	Vullnetare D&E Qendër e gjuhëve të huaja	9 2
4.	Kurs kitare	Qendra e Edukimit D&E	7
5.	Kurs gatimi për pica	Kompani Private Biznesi	4
6.	Intrakompjuter	Harry Fultz	1

Këshillim për punësim dhe punësimi

D&E ka mbështetur përfituesit e programit në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun formal të punës. Stafi i D&E orienton në mënyrë të vazhdueshme përfitueset/it të zgjedhin profesione të kërkuara në tregun e punës, duke u përshtatur natyrisht në çdo rast me aftësitë e tyre personale. Përfituesit trajnohen se si të paraqiten para punëdhënësit, si të kenë një komunikim efektiv me punëdhënësin, por edhe mbarëvajtje në punë, si të përgatisin një CV, etj. D&E ka bashkëpunuar ngushtë me Zyrën e Punësimit dhe kompanitë private gjatë kësaj periudhe. Të gjitha rastet e programit D&E janë regjistruar pranë Zyrrave Rajonale të Punësimit.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor, 47 përfitues/e kanë qënë në marrëdhënie pune.

23 përfitues/e VT /VMT kanë qënë në marrëdhënie pune të punësuar si: ndihmës kuzhinier/e në restorante dhe pasticeri, banakiere, kamarier/e, pjatlarëse në restorante, operator në Qendra Interneti and Call Center, pastruese, shpërndarës ushqimi, etc. 1 rast është punësuar përmes programit të internshipit.

24 përfituese VDH kanë qënë në marrëdhënie pune të punësuar si: kuzhinierë, nd/kuzhinierë, pastruese, shitëse në butik, operatore në Call Center, dekoruese eventesh, rrobapërdorues. pjatlarëse.

Programe internshipi me kompanitë e biznesit

Gjatë periudhës raportuese **4 përfituese kanë qenë të përfshirë në programin e internshipit**, tre raste viktime/viktima të mundshme trafikimi janë përfshirë në programin e internshipit duke punuar njëri berber në një dyqan berberi dhe dy raste të tjerë nd/kuzhinierë në dy restorante dhe një rast viktime e dhunës në familje është përfshirë në këtë program duke punuar në një restorant.

Një marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar me kompaninë e biznesit, për të përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

Këshillim dhe asistencë ligjore për viktimat e trafikimit

D&E ka ofruar asistencë ligjore për të gjithë përfituesit/et në program përmes avokatit dhe juristëve të D&E. Për raste të veçanta D&E ka bashkëpunuar edhe me OJF të tjera me ekspertizë për ndihmën ligjore si me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe TLAS. Gjatë periudhës raportuese të gjithë përfituesit e programit të riintegritit janë informuar për të drejtat e tyre dhe janë mbështetur me ndihmën ligjore të kërkuar.

4

përfituese të huaja janë mbështetur për të marrë lejen e qëndrimit të përkohshëm (për një periudhë 3 deri në 6 muaj me të drejtën e rinovimit). Aplikimi është bërë në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit në Tiranë dhe D&E ka ndjekur procedurën e bërjes së aplikimit dhe sigurimin e dokumentacionit.

1

përfituese e huaj është kthyer në vendin e saj të origjinës. Ajo është mbështetur me të gjitha dokumentet e nevojshme për kthimin e saj.

9

përfitues janë mbështetur për të aplikuar dhe pajisur me mjet identifikimi.



Avokati i D&E ka organizuar sesione me përfituesit duke diskutuar tema të ndryshme ligjore si:

- Të drejtat e viktimave të veprës penale;
- Njohja e legjislacionit që rregullon qasjen në procedurat penale;
- Të drejtat e Viktimave të Trafikimit dhe Dhunës në Familje;
- Ndiurma juridike dhe kategoritë që përfitojnë;
- Zgjidhja e martesës, kujdestaria e fëmijëve, detyrimi i ushqimit dhe përgjegjësia prindërore;
- Ngacmimi moral dhe seksual në vendin e punës;
- Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- Të drejtat e fëmijëve;
- E drejta për punë.



Asistenca Sociale

Trajnime dhe aktivitete për rritjen e aftësive për jetën

Për të rritur aftësitë për jetën të përfitueseve, stafi i D&E ka organizuar aktivitete të ndryshme në Qendrën e Edukimit dhe në Klubin Social. Kështu, përveç kurseve të organizuara si kompjuter, anglisht, italisht, piano dhe kitarë, janë organizuar gjithashtu diskutime të temave të ndryshme ligjore nga juristi dhe mjekësore nga mjekja e D&E; klubi i librave dhe klubi i filmave; terapi arti dhe kursi kreativiteti nga psikologu dhe një lehtësues; etj. Gjatë kësaj periudhe është organizuar trajnimi i përfitueseve në lidhje me dhënie e ndihmës së parë në rastet e:

- Arrestit kardiorespirator dhe si të aplikohet reanimimi zemër-mushkri;
- Trupave të huaj në rrugët e frymëmarrjes dhe në ezofag tek adultët dhe fëmijët;
- Aksidenteve vaskulocerebrale;
- Djegieve të gradave të ndryshme;
- Dehidratimit dhe hipotensionit, shenjat e para dhe trajtimi i tyre;
- Apandisit, si ta dallojmë;

Dy fëmijë të një përfitueseje kanë ndjekur një kurs futbollit.

Aktivitetet social – kulturore

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa aktivitete sociale për përfitueset. Aktivitetet janë organizuar si brenda dhe jashtë qendrës.



Aktivitetet e organizuara **brenda strehëzës** kanë qenë:

- *diskutime grupi* me tema të ndryshme;
- *festimi i festave* të ndryshme;
- *festimi i ditëlindjeve* të përfitueseve;
- *workshop-et e kuzhinës* nëpërmjet të cilave përfitueset mësojnë të gatujnë receta të ndryshme;
- *lojra të ndryshme argëtuese, energjike*;
- *përgatitja e punëve të dorës, qëndisje*;
- *mbrëmje muzikore* të organizuara çdo të shtunë;
- *leximi i librave* të ndryshëm nga biblioteka e D&E;
- *kinema* në shtëpi;
- *fitness, palestër*
- *lojra energjike*;
- *këngë dhe vjersha* për fëmijët në qëndër;
- *kafe në tarracë* e strehëzës

Janë organizuar një sërë aktivitete edhe jashtë strehëzës me karakter zbavitës por dhe informues.



Disa aktivitete të organizuara **jashtë strehëzës** janë:

- vizitë në Durrës;
- plazh në Gjirin e Lalzit;
- vajtja në kinema;
- koktej në një bar për ditën e San Valentinit dhe Ditën e Gruas;
- piknik në liqenin artificial të Tiranës;
- vajtja në Kishën e Lacit;
- vajtja e nënave me fëmijë në kënde lojrash apo lokale me lojra për fëmijët e tyre;
- drekë në lokal;
- shoping;
- shoqërimi i përfitueseve në kishë apo xhami.

Gjatë muajve Korrik dhe Gusht, të gjitha përfitueset e Qendrës së Riintegritimit kanë frekuentuar pishinën për dy javë. Në javën e fundit të korrikut u ofrua një përvojë e ngjashme edhe për meshkujt VoT, përfitues të programit të D&E. Ata u shoqëruan nga menaxheri i rastit dhe një vullnetar për të kaluar disa ditë në një pishinë, duke pasur kështu mundësinë të shoqëroheshin dhe të kalonin kohë të këndshme në një mjedis tjetër.



Programi i mentorimit

Gjatë këtij viti **katër mentorë** kanë ofruar mbështetje individuale në baza javore për disa përfituese të programit. Gjatë kësaj periudhe, **17 raste kanë pasur mentorin e tyre**. Mentorët ofrojnë mbështetje në baza javore në përputhje me nevojat e rasteve dhe mënyrat në të cilat janë planifikuar nga të dyja palët. Ky shërbim ofrohet përmes aktiviteteve dhe takimeve periodike.

Përmes mentorimit, rastet që ndjehen të izoluar dhe të stigmatizuara ndihmohen në fusha të tilla si ndërtimi i besimit, vetëbesimi, rritja e qasjes në burime të tjera në dispozicion dhe rritja e aftësive për të shmangur shfrytëzimin dhe për të shmangur marrëdhëniet e dëmshme personale.

D&E vazhdimisht ofron supervizim individual dhe në grup për mentorët, kështu që procesi i mentorimit është efektiv për përfituesin dhe vetë mentorin.

Aktivitetet e realizuara me rastet kanë qënë të larmishme duke ju përshtatur në çdo rast interesave dhe specifikave të rasteve të mentoruara.

Monitorimi dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve të programit

Përfitueset e fazës së dytë e të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet bazuar në nevojat e tyre. Progresi i riintegritimit të rasteve është monitoruar nga menaxherët e rasteve. Monitorimi është realizuar në baza ditore, javore dhe mujore; monitorimi ditor bëhet nga menaxherët e rasteve gjatë turnit të punës. Monitorimi javor dhe mujor realizohet në baza të rregullta nga menaxheri i rasteve të secilit prej rasteve dhe koordinatori i riintegritimit.

Monitorimi i përfituesve është kryer me anë të takimeve direkte, ashtu edhe me anë të kontakteve të rregullta me telefon. **Gjatë kësaj periudhe 2629 sesione këshillimi janë ofruar për përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit nga menaxherët e rasteve.**

Gjatë kësaj periudhe stafi ka monitoruar dhe ka bërë takime direkte me përfitueset të cilat jetojnë në qytetet e tyre të origjinës si Shkodër, Kukës, Berat, Kucovë, Elbasan.

Proçesi i monitorimit është fokusuar në çështje të shëndetit, punësimit, formimit profesional, arsimin, marrëdhëniet familjare, çështjet ligjore dhe psikologjike, menaxhimin e aktiviteteve dhe të ardhurave të përditshme etj.

Gjatë periudhës raportuese **15 përfitues VeT janë fuqizuar** dhe jetojnë në mënyrë të pavarur. Në total, **53 viktima /viktima të mundshme të trafikimit dhe 34 viktima të dhunës në familje janë monitoruar** nga stafi i D&E.



Ndihmë financiare dhe afatgjatë

Rastet VeT- 29 raste dhe 17 fëmijë të tyre janë mbështetur dhe asistuar në apartamente me qira; 21 raste janë ndihmuar në familjet e tyre dhe 3 raste dhe 3 fëmijë janë ndihmuar në vende të tjera alternative. 4 raste dhe 2 fëmijë kanë kaluar nga Qendra e Riintegritimit (QR) në apartamente me qira dhe 3 raste kanë kaluar nga QR për të jetuar me familjen e tyre. D&E ka vazhduar të ofrojë mbështetje financiare për qiranë e apartamentit për përfituesit e fazës së dytë të programit të riintegritimit.

Rastet viktima të abuzimit dhe dhunës në familje- 34 raste të viktimave të dhunës dhe 67 fëmijë të tyre janë asistuar me shërbime në komunitet.



Informacion mbi shërbimet në komunitet

Stafi i D&E ofron mbështetje të vazhdueshme për rastet duke u ofruar atyre informacionin e nevojshëm për shërbimet ekzistuese në komunitet.

Një hartë të shërbimeve në komunitet u shpërndahet përfituesve, të cilët në disa raste shoqërohen drejtpërdrejt nga menaxherët e tyre të rastit për të njohur drejtpërdrejt këto lloj shërbimesh.

Përfituesit informohen për të drejtën e tyre për të përfituar ndihmë ekonomike si VoT dhe ata mbështeten në përpilimin e dokumenteve të nevojshme.

Duke qenë se strehimi afatgjat për viktimat e trafikimit është një sfidë, menaxherët e rasteve të D&E kanë vazhduar të ofrojnë mbështetje dhe orientuar përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit për përgatitjen e dokumenteve të kërkuara për aplikimin në skemat e strehimit të Bashkisë së Tiranës. 6 përfitues kanë përfituar nga programi i bonusit të qirasë dhe / ose nga strehim social; një rast tjetër ka aplikuar dhe po pret vendimin e Komunës.

Mjeku i D&E ka orientuar dhe informuar përfituesit e ndihmuar në fazën e dytë të programit në mënyrë që të marrin trajtim specifik pranë Qendrave të Shëndetit dhe institucioneve të tjera shëndetësore.



Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit, VMT apo viktimave të dhunës në familje

Kthimi i viktimave të huaja në vendin e tyre të origjinës:

Gjatë kësaj periudhe D&E ka asistuar pesë raste të huaja të cilat vijnë nga vende të ndryshme. Një prej tyre ishte nga Bjellorusia, por jetonte në Itali me leje qëndrimi në këtë vend. Pas një periudhë kohe të caktuar të qëndrimit në programin e organizatës, ajo u kthye në Itali.

D&E ka bashkëpunuar ngushtë me Autoritetin Përgjegjës në asistimin e rastit për kthimin e saj në vendin ku jetonte para situatës së trafikimit dhe shfrytëzimit.

Kthimi i viktimave shqiptare të identifikuara jashtë vendit:

Gjashtë raste shqiptare, një pjesë e tyre të identifikuara jashtë vendit, janë rikthyer në Shqipëri. Rastet kanë ardhur nga vende të ndryshme si: Hollanda, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar. Sapo kanë hyrë në program, për secilin prej rasteve është ofruar një paketë e plotë e shërbimeve të riintegrit bazuar dhe në nevojat e tyre.



Rritja e përpjektjeve për identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet Njesisë Lëvizëse

Gjatë vitit 2018, Njësia Lëvizëse e D&E ka realizuar një sërë aktiviteteve si më poshtë:

Kontakte Direkte

me personat të cilët vijnë nga familje apo grupe vulnerabël në zonat problematike të qytetit të Tiranës. Gjatë kësaj periudhe janë kontaktuar në mënyrë direkte **39 persona nga komuniteti i Kamzës, Laprakës, Kombinatit, Shkozës, Shinat e Trenit**. Një pjesë e tyre janë ndihmuar që të marrin shërbimet përkatëse bazuar në nevojat e tyre. Pjesa

më e madhe e tyre janë ndërmjetësuar për të marrë shërbime të ndryshme si: shërbime mjekësore, shërbime për gjetjen e një vendi pune apo për plotësimin e dokumentave të tjera për bonus qeraje, ndihme ekonomike apo për përfitimin e një banesë sociale.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, janë ndihmuar 39 raste.

Shërbimet e ofruara	Regjistrim në zyrën e punës si punëkërkues i papunë si dhe ndihmë në gjetjen e punës.	Regjistrim për kurse profesionale në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional	Referim tek NJMF-të ose organizatat partnere për shërbimet përkatëse
Numri i rasteve	10 Raste	4 Raste	25 Raste

Në muajin Tetor 2018, Njësia Lëvizëse Tiranë u riaktivizua duke punuar në mënyrë më intensive në terren falë mbështetjes së projektit “Të rrisim përpjekjet proaktive për identifikim dhe referim të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në nivel lokal”, mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogëla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

Një marrëveshje e re bashkëpunimi është firmosur gjatë kësaj periudhe ndërmjet “Të Ndryshëm & Të Barabartë” dhe Policisë së Tiranës. Përmes kësaj marrëveshjeje, MU do të bashkëpunojë ngushtë me Njësinë Antitrafik të Qarkut Tiranë si në dhënien e informacioneve reciproke, ndjekjen e rasteve të dyshuara si viktimave të mundshme trafikimi, dhënien e informacionit për shfrytëzuesit apo vendet e shfrytëzimit etj. Gjithashtu është bërë dhe një takim me Autoritetin Përgjegjës, në lidhje me punën e Njesisë Lëvizëse.

Indentifikimi dhe Referimi i Viktimave të Mundshme të Trafikimit

Prej Tetorit 2018 deri në fund të dhjetorit 2018, **15 raste janë identifikuar si viktimave të mundshme trafikimi, dhe janë referuar tek NJMF përkatëse: NJMF e Njesisë Administrative KAMZË (7 raste), NJMF e Njesisë Administrative nr.9 (3 raste), NJMF e Njesisë Administrative nr.10 (1 rast), NJMF e Njesisë Administrative KASHARIT (1 rast), NJMF e Njesisë Administrative nr .2 (1 rast), NJMF e Njesisë Administrative nr.8 (1 rast),NJMF Njesisë Administrative nr.5 (1 rast). 6 prej të cilëve janë djem dhe 9 vajza.** Janë bërë pjesë e programit të D&E 9 raste , 3 – djem dhe 6 – vajza të cilat po përfitojnë paketën e plotë të shërbimeve që organizata ofron. Njësia Lëvizëse e Tiranës gjatë 2018, ka marr pjesë në GTN-të që janë zhvilluar për identifikimin dhe referimin e rasteve. Janë kryer vizita në familje nga Njësia Lëvizëse në bashkëpunim dhe me NJMF-në e Tiranës.

Sesione informimi ne shkolla

Në kuadër të muajit Tetor, i konsideruar muaji anti –trafikim nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave janë zhvilluar disa sesione informimi në shkollat 9 –

vjeçare dhe të mesme të qarkut të Tiranës, përkatësisht në **13 shkolla 9 – vjeçare dhe 6 gjimnaze të Qarkut të Tiranës**. **870 nxënës të këtyre shkollave ishin pjesë e sesioneve.**

Sesione informimi janë realizuar edhe në qytetin e *Rrogozhinës*. Aktivitetet u realizuan në **tre shkolla të qytetit** në bashkëpunim me psikologun e shkollës dhe stafin akademik. Sesionet u realizuan përkatësisht në: shkollën e mesme “Haxhi Qehaj” dhe shkollat nëntëvjeçare “Qamil Gjuzi” & “Lekaj”. **145 nxënës ishin pjesë e sesioneve.**



Forume dhe fokus grupe informuese

Në kuadër të aktiviteteve informuese, në Tetor 2018 është zhvilluar një Forum me Gratë e Komunitetit në Njësinë Administrative nr.11. Gjithashtu është organizuar dhe një fokus grup në **Nëntor 2018** në Ambjentet e Njësisë Administrative nr.11.

Trajnime me profesionistë

Në kuadër të projektit “Të rrisim përpjekjet proaktive për identifikim dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në nivel lokal” janë organizuar 2 trajnime në muajin Dhjetor, me institucione të ndryshme të cilat janë në kontakt me grupet e cënueshme, për të rritur rolin e tyre në identifikim dhe referim.

Trajnimi i parë u organizua më **4 Dhjetor 2018** me punonjësit e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në këtë trajnim morën pjesë 22 punonjës të NJMF-ve.

Trajnimi i dytë u organizua më **17 Dhjetor 2018** me psikologët e shkollave në gjithë Qarkun e Tiranës. Në këtë trajnim morën pjesë 40 psikologë të shkollave.

Trajnimet do të vazhdojnë dhe në 2019, me institucione të ndryshme, të cilat janë në kontakt me viktimat / viktimat e mundshme të trafikimit.

Në **Dhjetor 2018** është bërë një takim me përfaqësues të Komisarariatit nr.3 për të rritur bashkëpunimin me oficerët e policisë që punojnë në komunitet dhe sidomos ata që adresojnë dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në vazhdim do të kryhen takime dhe në komisarariatet e tjera të Qarkut të Tiranës.

Rritja e aksesit të viktimave në sistemin e drejtësisë

Projekti **“Drejtësia është histori e vërtetë kur në plan të parë janë viktimat”** ka për qëllim të ndihmojë dhe mbrojë viktimat e krimit (viktimat e trafikimit, viktimat e abuzimit seksual, viktimat e dhunës në familje), në mënyrë të veçantë viktimat e trafikimit nëpërmjet:



- ofrimit të ndihmës direkte dhe ndihmës ligjore falas;
- rritjes së kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit;
- rritjes së informacionit për të drejtat e viktimave dhe aksesit në drejtësi;
- dhe advokimit për të përmirësuar legjislacionin.

D&E në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare ka mbështetur në rast viktimë trafikimi në gjykatë për të kërkuar të drejtën e kompensimit. Çështja përfundoi në favor të viktimës. Gjithsej për këtë rast janë mbajtur 29 seanca gjyqësore. Aktualisht çështja është në Gjykatën e Apelit.

Projekti po zbatohet me mbështetjen financiare të “Save the Children” në partneritet me “Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”, me fonde të Bashkimit Evropian. Mbështetja për viktimat e veprës penale ofrohet aty ku viktimat ndodhen, ndërkohë që aktivitete të veçanta të projektit janë përqëndruar kryesisht në Tiranë, Elbasan, Fier, Kukës, Korçë, Dibër, duke përfshirë edhe zonat rurale.

Asistencë ligjore për viktimat e veprës penale

D&E vazhdon të ofrojë asistencë ligjore për të gjithë përfituesit/et që janë pjesë e programit të riintegrit. Në bazë të nevojave të veçanta të secilit përfitues është ofruar: **Asistencë e drejtpërdrejtë për të gjithë viktimat e krimeve** (viktima të trafikimit, viktima të abuzimit seksual, viktima të dhunës në familje, abuzimit të fëmijëve). Në veçanti viktimat e trafikimit asistohen me ndihmë dhe këshillim ligjor

gjatë gjithë procesit të riintegritit përfshirë identifikimin, sigurimin e shërbimeve dhe përfaqësimin në gjykata, si dhe lehtësimi i çdo procedure që ndikon në dhënien e ndihmës dhe mbrojtjen e tyre.

Gjatë vitit 2018 D&E ka rritur kapacitet për ofrimin e ndihmës ligjore për përfituesit duke arritur këto rezultate konkrete:

Janë ofruar shërbime dhe informacione për të drejtat e tyre ligjore për të gjithë përfituesit e D&E, **në total 112 përfitues;**

Janë organizuar 9 seanca informuese me temë "Për të drejtat e viktimave", me pjesëmarrjen në total të 229 persona nga grupe të veçanta (viktima të trafikimit, viktima të abuzimit seksual dhe viktima të dhunës në familje), studentë, punonjës që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me viktimat dhe OJF lokale. Këto aktivitete janë zhvilluar në qytetet Tiranë (5 sesione informimi), Korçë, Elbasan, Peshkopi dhe Kukës.

Janë organizuar **4 trajnime** me temë "Të drejtat e viktimave të veprave penale", në qytetet Tiranë, Fier, Korçë dhe Elbasan. Në këto trajnime kanë marrë pjesë rreth **117 përfaqësues** të Institucionve të ndryshme si: Drejtoritë e Policisë (sektori antitrafik dhe dhuna në familje), Prokuroria, Gjykatat, Dhoma e Avokatishë, Zyrat Përmbarimore, Përfaqësues nga Komitetet Rajonale Antitrafik dhe OJF të tjera që punojnë për mbrojtjen e viktimave.



Janë përgatitur dhe botuar **1000 broshura informative dhe 200 postera**. Informacioni në broshurë është i fokusuar në të drejtat e viktimave të krimit dhe në promovimin e linjës së këshillimit, të cilat janë shpërndarë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të D&E.



Ndihma ligjore pro bono ka qenë një ndër risitë e projektit. Avokatët privatë nga 3 qarqe (Dibra, Korca dhe Saranda) kanë rënë dakort të ofrojnë ndihmë juridike falas (pro bono) për përfituesit e D&E.

Prej muajit Janar 2018 është ngritur dhe është aktive linja e këshillimit.

Numrat e linjës së këshillimit:
+3555 4 2200 400 & +355 67 2200 400

Linja e këshillimit është përdorur nga përfituesit/et për informim për të drejtat e tyre ligjore, për mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore dhe ka patur referime edhe të rasteve të reja (12 raste të reja gjatë vitit 2018).

Asistenca ligjore për rastet është ofruar në varësi të nevojave të tyre kryesisht për:

- Përfaqësim ligjor i rastit në gjykatën civile dhe penale
- Ndjekja e procedurave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore
- Asistencë për shërbimet në bashki (bonus qeraje)
- Informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
- Regjistrimi në regjistrin civil
- Aplikim për leje qëndrimi
- Asistencë në ZVRPP

Advokimi dhe Analiza Ligjore për hartimin e Ligjit kundër Trafikimit

D&E ka vazhduar të advokojë gjatë këtij viti për nevojën e hartimit të një ligji të posaçëm për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Bazuar në kërkesën e D&E është parashikuar një aktivitet i veçantë për vlerësimin e nevojës për hartimin e një ligji të posaçëm për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Ky aktivitet është përfshirë tashmë në Planin Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për 2018-2020, të miratuar me VKM nr. 770, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për 2018-2020”.

Shërbime alternative të përkujdesjes së fëmijëve të nënave viktima trafikimi dhe viktima të dhunës në familje



Gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar të funksionojnë të dy alternativat e përkujdesjes së fëmijëve “Shtëpia e Gjyshes” dhe kopshti “Shkoza e Re” të hapura në Maj 2017. Një pjesë e kostove operacionale të alternativës në kopshtin “Shkoza e Re” edhe gjatë këtij viti janë mbuluar falë marrëveshjes së bashkëpunimit me Bashkinë Tiranë.

Të dyja alternativat ofrojnë përkujdesje përtej orarit zyrtar të funksionimit të kopshteve dhe çerdheve publike, shkollave – nga e hëna në të shtunë. Gjatë periudhës së qëndrimit në alternativa për fëmijët ofrohet

përkujdesje e specializuar, ushqim, aktivitete të personalizuar edukative dhe argëtuese në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre etj. Fëmijët në moshë shkollore mbështeten rregullisht nga mësueset për të përgatitur detyrat e shtëpisë.

Gjatë këtij viti, 28 fëmijë të nënave ish- viktima trafikimi dhe viktima të dhunës në familje kanë frekuentuar rregullisht 2 alternativat e përkujdesit të fëmijëve në Tiranë dhe janë duke përfituar në mënyrë direkte nga ky lloj shërbimi.

Gjatë peridhës Janar –Dhjetor 2018 është ndërmarrë dhe realizuar *një vlerësim mbi situatën e mbrojtjes së fëmijëve të viktimave me qëllimin kryesor për të eksploruar nevojat, praktikat më të mira dhe për të planifikuar zhvillimin e tyre të mëtejshëm*. Vlerësimi bëri të mundur identifikimin e bashkive ku do të ngriheshin 3 alternativat e reja të përkujdesjes së fëmijëve. *Bashkitë e identifikuara nga vlerësimi ishin: Elbasan, Kamëz dhe Shkodër*.



Në muajin Nëntor 2018 u hap alternativa e përkujdesit mbasdite në Elbasan. Kjo nismë u realizua në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan dhe shoqatën “Tjeter Vizion”.

Gjatë kësaj periudhe 10 fëmijë kanë frekuentuar rregullisht këtë alternativë.



Ambjenti i vënë në dispozicion nga Bashkia Elbasan për hapjen e alternativës, në një nga kopshtet publike të qytetit të Elbasanit u rikonstruktua dhe u mobilua për të qënë një ambjent sa me miqësor dhe i këndshëm për fëmijët.

Ndërkohë po vijon puna për hapjen e alternativave të përkujdesit edhe në *Bashkinë e Shkodrës* dhe *Kamzës*. Janë vendosur tashmë kontaktet e duhura me institucionet lokale dhe po eksplorohet mundësia e gjetjes së ambjentit të përshtatshëm për hapjen e alternativave. Një sërë takimesh konsultative janë organizuar me stafin e Bashkive respektive, Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Shërbimin Social Rajonal.

Në Dhjetor 2018 ka filluar puna për përgatitjen e Manualit për Menaxhimin e rasteve të Fëmijëve të viktimave të trafikimit dhe të dhunës në familje. Ky manual i vogël ka për qëllim t’ju japë profesionistëve të shërbimeve sociale orientimin dhe udhëzimin e nevojshëm për të menaxhuar efektivisht këtë target -grup fëmijësh.

“Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”

Në Shkurt 2018 D&E në partneritet me Qendrën për Kujdesin e Familjes dhe Fëmijëve (KMOP) filloi zbatimin e projektit “Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian – si pjesë e programit për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Medias 2016 - 2017.

Zonat e shtirjes së projektit janë: Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë.

Projekti synon të fuqizojë organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, në ofrimin e shërbimeve riintegruese për viktimat e trafikimit/ dhunës në familje dhe të arrijë një përfshirje sociale harmonike të ish-viktimave, kryesisht përmes rritjes së nivelit të tyre të punësimit.

Aktiviteti prezantues i projektit u organizua në formën e një tryezë të rrumbullakët (24 Maj 2018) për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve kyç në nivel lokal dhe qendror, përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile mbi risitë që do të sillte zbatimi i projektit në jetën e vetë të mbijetuarave të trafikimit dhe dhunës në familje.



Pjesëmarrësit në aktivitet ndanë opinione dhe rekomandime shumë të vlefshme për të rritur nivelin e mbrojtjes, asistencës dhe fuqizimit të ish-viktimave në shoqërinë shqiptare.

Gjatë periudhës **Prill – Gusht 2018** u realizua Vlerësimi i Kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile. Një mjet vlerësimi u hartua me qëllimin për të matur kapacitetin e OShC-ve në dy drejtime: si antare të shoqërisë civile dhe si ofrues potencial shërbimesh për viktimat. Mjeti i vlerësimit u aplikua nga organizatat që dakortësuan në të 4 qarqet ku zbatohet projekti.



Vlerësimi ndihmoi në identifikimin e nevojave për ngritje kapaciteti të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë, si edhe në përgatitjen e një dokumenti me kriteret minimale që një organizatë e shoqërisë civile duhet të ketë për të ofruar shërbime cilësore riintegruese për viktimat e trafikimit dhe të dhunës në familje.

Trajnimet për organizatat e shoqërisë civile që punojnë në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë u realizuan gjatë periudhës **Nëntor – Dhjetor 2018**.

Trajnimi i parë 3 ditor kishte qëllim rritjen e informacionit të organizatave mbi çështje të lidhura me ofrimin e asistencës dhe shërbimeve mbrojtëse për viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje etj.




Kurse i dyti kishte në fokus rritjen e informacionit mbi kuadrin ligjor dhe rregullator mbi të cilin mbështeten dhe operojnë OJF-të në Shqipëri, qeverisja dhe menaxhimi i organizatës, zhvillimi organizativ i organizatave, menaxhimi financiar etj.



Klubi i Kauzës Sociale është konceptuar të shërbejë si një vend joformal për viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje për t'u socializuar, për të organizuar aktivitete dhe për të ofruar shërbime mbështetëse (mentorim, trajnim profesional etj.), si një qendër burimore

- shkëmbim informacioni mbi mundësitë, si dhe do të shërbejë si pikë për mbledhjen e donacioneve. Klubi funksionon në bazë të një **plani javor** dhe **mujor**, i dakortësuar pas **konsultimit të vazhdueshëm me antaret e Klubit**.



“Studimi mbi aftësitë dhe shprehjet që kërkon/ ofron tregu i punës” u realizua në katër zonat e projektit. Rezultatet e studimit

do të ndihmojnë në identifikimin e formimit profesional apo të bizneseve që individët ish-

viktima/ të mbijetuara të dhunës dhe trafikimit mund të ndërmarrin, si edhe në mbështetjen që ato do të duan nga autoritetet lokale apo OSHC-të që veprojnë zona. Drafti i parë i studimit u prezantua në një tryezë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Ministrisë



së Buqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik/ Ministrisë së Brendshme, Qendra të Formimit Profesional, Zyrës Rajonale të Punësimit Tiranë/ Dibër/ Sarandë, Bashkisë Tiranë/ Kukës, organizata të shoqërisë civile, Dhoma e tregëtisë etj.



Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, u realizuan 4 sesione informimi me vajza dhe gra në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë. Sesionet informuese u realizuan në partneritet me Shërbimin Kombëtar të Punësimit/ Drejtoritë Rajonale të Punës në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë.



Gjatë sesioneve u dha informacion mbi fenomenin e dhunës me bazë gjinore, format e kësaj dhune, pasojat, shërbimet në mbështetje të viktimave, format e raportimit etj., por edhe për shërbimet që vajzat dhe gratë mund dhe duhet të aksesojnë për të qenë të afta ti thonë: “Stop dhunës”.



Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushata anti-trafikimi

Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte përdorimi i qasjes parandaluese për të rritur përfshirjen e të rinjve në parandalimin e trafikimit në persona. Projekti është zbatuar gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2018**, në tre qytete të Shqipërisë: Korçë, Gjirokastrë dhe Shkodër dhe është mbështetur financiarisht nga **Fondacioni Arise**.

- Janë përzgjedhur dhe janë krijuar 3 grupe të rinjsh me nga 15 persona në treja qytetet e projektit - Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër;
- Janë realizuar 3 trajnime për ngritjen e kapacitetit të të rinjve të përzgjedhur në lidhje me: njohjen e fenomenit të trafikimit, dizenjimin e fushatave ndërgjegjëse dhe të folurim në publik;
- Të rinjve ju ofrua gjithashtu mundësia për të ndjekur një kurs kompjuteri për ti ndihmuar të draftonin materialet ndërgjegjëse të fushatave të tyre;
- Të rinjtë përgatitën dhe përdorën një sërë mjetesh në fushatat e tyre ndërgjegjëse si piktura, fletëpalosje, postera, vizatime, poezi, ese, filma të animuar dhe performanca të tjera.
- Gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2018, grupet e të rinjve kanë zhvilluar 30 aktivitete ndërgjegjëse në qytetet respektive për bashkëmoshatarët e tyre por jo vetëm ;
- Në muajin Dhjetor 2018 grupet e të rinjve organizuan 3 aktivitete përmbyllëse (një në secilin qytet) për të



ndarë me përfaqësuesit e institucioneve/ mësuesit apo prindërit punën e bërë gjatë zbatimit të fushatave.

Mbështetja e viktimave të trafikimit për të dizenuar dhe zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi

Për herë të parë në Shqipëri, një grup vajzash, të mbijetuara të trafikimit, përfituese të D&E ideuan dhe realizuan një fushatë ndërgjegjësimi anti –trafikim në mbështetje të vajzave dhe grave që janë pre e trafikimit. Kjo fushatë erdhi si ide nga vetë të mbijetuarat të cilat po riintegroheshin në jetën sociale pas eksperiencës së dhimbshme të trafikimit. D&E ka mbështetur dhe lehtësuar procesin e dizenjimit të fushatës duke i kthyer idetë e tyre në art, materiale informative etj.

Slogani i fushatës ishte: “Une jam Si Ti! Une ja dola mbanë! Edhe ti mundesh!”

Kohëzgjatja e fushatës: 19 Prill – 30 Korrik 2018

Prej fillimit të saj, fushata e të mbijetuarave u mbështet fuqimisht nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti- trafik/ Ministria e Brendshme dhe në mënyrë të vecantë nga vetë **Zv. Ministria e Brendshme, Zj. Rovena Voda.**

Aktivitetet kryesore të fushatës:

Ekspozita fotografike ishte aktiviteti i parë i fushatës. Gjatë aktivitetit u prezantua edhe një *Photo voice* (historia e një viktimë trafikimi e transmetuar me foto), si edhe *posteri i fushatës*. Fotot e ekspozitës tregonin trafikimin, shfrytëzimin, dhunën, abuzimin ashtu siç të mbijetuarat e kishin përjetuar. Disa nga fotot transmetonin gjithashtu edhe mesazhe shprese dhe besimi për një të ardhme më të mirë.



Fotografitë e ekspozitës së bashku me disa poezi të krijuara nga VeT u bënë pjesë e një albumi fotografish, i publikuar dhe shpërndarë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjërë/vetë viktimave të trafikimit.



Një video e shkurtër me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin u përgatit nga një prej të mbijetuarve që ishin pjesë e fushatës. Videoja e shkurtër prej 30' përmbante fakte konkrete rreth shkallës së skllavërisë moderne sot / udhëzime se si të raportojnë rastet e viktimave të trafikimit etj. Video u prezantua për një muaj në monitorët e disa linjave të autobusëve të qytetit të Tiranës.

Instalacioni ndërgjegjëses **#UNËJAMSITI** u inagurua në 30 Korrik, Dita Ndërkombëtare kundër Trafikimit në ambjentet e Parkut "Rinia". Pas parkut "Rinia", instalacioni u vendos në ambjentet e Drejtorisë së Policisë në Tiranë.



“EDHE ZËRAT TANË”

Ky projekti realizohet me mbështetjen financiare të Fondacionit OAK dhe koordinohet nga Qendra Ndërkombëtare e Kërkimit për shfrytëzimin seksual të fëmijëve, dhunën dhe trafikimin në Universitetin Bedfordshire në Angli. Projekti po zbatohet paralelisht në **Shqipëri, Serbi dhe Moldavi**. “Të Ndryshëm & Të barabartë” është organizata partnere për Shqipërinë.



Projekti ka për qëllim të rrisë kapacitetet e të rinjve të prekur nga dhuna seksuale për të dhënë kontributin e tyre në ndryshimin e çështjeve/ problemeve që kanë rëndësi për ta, si edhe të ngrejë kapacitetet e profesionistëve për të ndërmarë aktivitete etike advokuese me të rinjtë për dhunën seksuale ndaj fëmijëve.

Fushata “Hope ON”

Fushata "Hope on" ishte një fushatë ndërgjegjësuere e cila u fokusua rreth problemit të trafikimit të qënieve njerëzore në nivel rajonal.

Për herë të parë u lançua më 18 Tetor 2018, në “Ditën Evropiane të luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore” e mbështetur nga OJQ-të e shtatë vendeve të rajonit Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Slloveni, Bosnje & Hercegovinë dhe Kroaci. Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi rajonal ishte qartësimi i nivelit të informacionit mbi fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore, rritja e ndërgjegjësimit mbi shkaqet e mundshme dhe pasojave të pallogaritshme të tij etj.



“Të Ndryshëm & Të Barabartë” u bë pjesë aktive e fushatës duke publikuar materiale të ndryshme ndërgjegjësuere në rrjetet sociale si historitë jete të të mbijetuarave nga trafikimi, statistika në nivel kombëtar mbi fenomenin, video sensibilizuese etj.

Programi i fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit të D&E

- ❖ Trajnime dhe prezantime të ofruara nga D&E
- ❖ Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit
- ❖ Aktiviteti për ngritjen e fondeve
- ❖ Botime dhe publikime të D&E
- ❖ Vlerësime, çmime



Pjesëmarrje të stafit në trajnime

- Trajnim ***“Çelësi për menaxhimin e suksesshëm të granteve”***, ofruar nga Arise Foundation, 10-11 Prill 2018;
- Trajnim ***“Parandalimi i konsumimit profesional”*** organizuar nga D&E dhe ofruar nga një eksperte në këtë fushë;
- Trajnim ***“Fuqizimi i grave në Shqipëri për sigurimin e barazisë gjinore”***, organizuar nga qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe ofruar nga eksperte e huaj, 03 – 04 Korrik 2018;



- Workshop për OJF-të për të ofruar shërbime të koordinuara për viktimat e trafikimit (VeT) me theks në referimet ndërkufitare, 8 Maj 2018, Budva/ Mali I Zi;
- Konferencë ***“Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe ndërgjegjësimi për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkan, Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Kosovë” dhe trajnim mbi “Procedurat Standarde të Veprimit të Unifikuara (PSVU) për Bashkëpunimin Transnacional dhe Menaxhimin e Rasteve për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme e trafikimit me një fokus të veçantë tek fëmijët midis Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi”***, 3 - 4 Korrik 2018, Shkup/ Maqedoni.
- Trajnimi Kombëtar mbi ***“Procedurat standarde të veprimit të unifikuara (PSVU) për bashkëpunim ndërkombëtar në menaxhimin e rasteve”***, 23-24 Tetor 2018, Tiranë.
- Trajnim ***“Krijimi i koalicionit për zgjidhjen e problemeve të komunitetit me abuzimin e drogës dhe alkoolit”***, 04 - 05 Tetor 2018, Tiranë.
- Trajnim nga Regional Social Academy e rrjetit IRIS ***“Protection Sensitive Migration Management”***, 26-29 Nëntor 2018, Beograd/ Serbi.

- Workshop “*Modeli i bazuar në shërbime në komunitet për riintegrimin e viktimave të trafikimit*”, 12-13 Dhjetor, Durrës.

Supervizim

Takime individuale supervizimi janë ofruar një herë në muaj për stafin që punon direkt me viktimat e trafikimit/ abuzimit seksual dhe dhunës në familje, ndërkohë një herë në muaj organizohet edhe një takim grupi.

Shkëmbim eksperiencash

Në datat 11 - 12 Shtator 2018, “D&E” mori pjesë në një shkëmbim eksperiencash në Gjermani. Dy përfaqësues nga D&E shkëmbyen informacione me përfaqësuesit e tre organizatave të huaja Gjermane me vendodhje në Mainz – organizata Solwodi, Frankfurt – organizata Fim dhe Stuttgart – organizata për ndërkombëtarët Fiz. Takimet konsistuan në dhënien dhe shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave të organizatave pjesëmarrëse. Organizatat prezantuan misionin e tyre, grupet e targetuara si dhe shërbimet që ofrojnë, vëshirësitë dhe sfidat që hasin në punën e tyre.

Trajnime dhe prezantime të ofruara nga D&E

- ❖ Prezantim i organizatës D&E në Simpoziumin Ndërkombëtar organizuar në Gjermani, Prill 2018;
- ❖ Prezantim “Faktorët e vulnerabilitetit dhe modelet parandaluese” organizuar në Vienë, Maj 2018;
- ❖ Prezantim në kuadër të Mekanizmit Transnacional të Referimit organizuar në Maqedoni, Qershor 2018;
- ❖ Prezantim “Studim i rasteve të shfrytëzuara në UK” në **Takimin e Mësimet Reciprok** në kuadër të projektit “**Cënueshmëria nga Trafikimi: Një studim i Vietnamit, Shqipërisë, Nigerisë dhe Mbretërisë së Bashkuar**”, organizuar në Tiranë nga IOM dhe Universiteti Bedfordshire në UK;
- ❖ Prezantim në kuadër të projektit “Our Voices Too”, organizuar në UK.
- ❖ Prezantim në trajnimin e I-rë kombëtar mbi Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, 26, 28 Shtator. Pjesëmarrësit në trajnim ishin rojet kufitare dhe oficerët e zbatimit të ligjit të autoriteteve përkatëse kombëtare përgjegjës për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit

D&E ka marre pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik.

- D&E është përfshirë edhe në hartimin e Planit të Veprimit Antitrafik për periudhën 2018-2020; Bazuar në kërkesën e D&E, pjesë Planit të Veprimit¹ është edhe një aktivitet i veçantë për vlerësimin e nevojës për hartimin e një ligji të posaçëm për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
- Takimet e organizuara në kuadër të Mekanizmit Kombëtar të Referimit;
- Mbledhje të Autoritetit Përgjegjës në lidhje me diskutimin e rasteve të vështira;

Aktivitetet e organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

■ Takime konsultuese mbi projektvendimet:

- Proçedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve;
- Rregullat e funksionimit të Grupit Teknik;
- Proçedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar;
- Për proçedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge;
- Aktet të tjera nënligjore në zbatim të ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” dhe “Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

■ Takime konsultative për “Planin Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e fëmijeve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijet në situatë rruge”

¹ VKM nr. 770, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore për 2018-2020”.

- D&E ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti –trafik.

Aktivitetet e Koalicionit “Drejtësi për të Gjithë”

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” është anëtare e Koalicionit “Drejtësi për të Gjithë” (DPGJ) që prej themelimit në Korrik 2016. Që prej muajit Shtator 2018 përfaqësuesi i D&E është zgjedhur kryetar i Bordit Ekzekutiv të Koalicionit. Koalicioni i cili është shumë aktiv në të gjithë veprimtarinë e tij.



D&E ka marrë pjesë në mënyre aktive në hartimin e planit Social të Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me ESA CONSULTING dhe me disa organizata të tjera partnere që operojnë në zonën e Kamzës.

Aktiviteti për ngritjen e fondeve



Gjatë këtij viti, D&E organizoi aktivitetin e rradhës për ngritjen e fondeve. Aktiviteti i organizuar në Janar 2018, u ideua në formën e një koncerti realizuar pranë Qendrës Kulturore të Kishës Ortodokse nën sloganin “ ENDE KA JETE”.

Me mbështetjen e disa partnerëve si “Geraldina Sposa” dhe “Le Spot Group”, nën skenarin e Zefina Hasanit dhe pjesëmarrjen e jashtëzakonshme të **Juliana Pasha, Aurela Gaçe, Elton Deda, Eneda Tarifa, Keisi Tola dhe Olta Boka.**

Përveç të kënduarit e këngëve ata u përfshinë gjithashtu në leximin e disa

historive të vërteta të viktimave të trafikimit. Në këtë Koncert Bamirësie na nderuan me prezencën e tyre shumë personalitete ku ndër ta përmendim Presidentin e Republikës Z. Ilir Meta.



Botime dhe publikime të D&E

1. Botimet e mëposhtme janë realizuar në kuadër të fushatës *“Unë jam si ti! Unë rimora në dorë jetën time! Edhe ti mundesh!”*

■ Poster



■ Album fotografish



■ Video ndërgjegjëse:



https://www.youtube.com/watch?time_continue=5&v=rzHd5eqKJv8



<https://www.youtube.com/watch?v=SB6wKLPLDG8>



<https://www.youtube.com/watch?v=wO3IsNh7QLU>

- II. Botimet e mëposhtme janë realizuar në kuadër të projektit "*Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushata anti-trafikimi*" :



Çmime

Në 25 Vjetorin e IOM Albania, KKSAT (Koalicioni Kombëtar i Stehëzave Anti-trafik) në të cilin “D&E” është anëtare (në këtë periudhe dhe në cilësinë e liderit të KKSAT) u vlerësua me çmim për kontributin në punën me viktimat e trafikimit.

